

Visar Zhiti
POLONIA – E BUKUR SI POEZIA E SAJ...

- Polonia është e bukur si poezia e saj, - kështu thosha me vete, kur endesha rrugëve të Varshavës në prag të një Krishtlindjeje...

Mbylla portën e Shtëpisë së Letërsisë në rrugën Krakovia dhe dola në sheshin e madh me bredhin verior në mes si i mbushur me yje dhe më kapi një ndjesi bore, me vezullonte në shpirt. Kishte rënë borë a do të binte së shpejti, por Varshava përçonte diçka të argjendtë, luksin e saj mondan gjithandej, as të vjetër e as të ri, por të përhershëm.

Ja, Pallati Mbretëror. Më tej Presidenca, statuja e një princi mbi kalë...

Tramvajet mes veturave turreshin si kope moderne qytetase. Kalimtarë të shumtë, që shtoheshin në mbrëmje, të veshur mirë, pallto të mëdha të errta, dorashka, zonja me kapele republike, me ngjyra, fustane të gjata, çizme.

Varshava është si një grua e bukur! U ktheva në një kishë, ku gjeta se ishte zemra e Shopenit, e futur në një nga muret e saj dhe m'u duk sikur qirinjtë dignin tinguj. Ajri dhe jashtë vazhdonte të kumbonte.

Më tej statuja e Kopernikut dhe më këtej piedestali i lartë, i rrethuar me pak kopësht dhe hija e bronzte, sovrane e poetit Adam Mickieviç.

Polonia i ka dhënë botës gjenitë e vetë, thashë përsëri me vete dhe po kujtoja autorët polakë të përkthyer në shqip: Mickieviçi po, herët, qysh në kohën e diktaturës, por duhej të binte diktatura që të botoheshin Henrik Sienkeviç, çmimi Nobel, romani i famshëm "Quo vadis". Edhe poeti Czeslaw Milosz ka çmimin Nobel, edhe Wislawa Szymborska... Zbigniew Herbert ma dhuroi një diplomat në Romë, Nobelisti ynë i munguar, më shkruante ai... Adam Zagajewski, kandidat për Nobel, "Perandori" i Kapuscinkit. Gazetari i lirisë tani Adam Michnik, që kishin ardhur aq mirë në shqip... poezitë e Papa Vojtilës, të botuara në Kosovë, kisha përkthyer dhe unë ca poezi prej tij... e deri tek Eva Lipska... ikja dhe ktheja kokën pas, më dukej sikur do më thërriste ndokush, ja, ndonjëri nga ata që kisha lexuar, megjithëse ishte hera e parë që vija në Poloni. Ishim vendosur në shtëpinë e Letërsisë, në katet e dyta e të treta të së cilës ishin zyrat e shoqatave të shkrimtarëve dhe të PEN-i polak.

Më tej diku, në thellësi të një parku, pashë flakë. Digjej pa u shuar. Rojet e nderit. Varret e të rënëve...

Po lumi ku është, nga? Kërkoj një urë nëpër muzg dhe ujanën që rrjedh si koha. Lumi Vilma dhe lumë makinash në rrugën e gjerë anash.

Pastaj shkuam në lagjen e vjetër, e cila u shkatërrua e gjitha gjatë luftës dhe u ribë siç ishte. Trokonin hapat tanë mbi kalldrëmin si kujtesa, po kërkonim një lokal hebre...

Stacioni i trenit i madh plot me njerëz. Me dy miqtë e mi nga Kosova, poetin dhe përkthyesin Mazllum Saneja, që jeton në Poloni dhe shkrimtarin Agim Gjakova po presnim trenin e linjës Varshavë/ Budapest/ Pragë. Në stolin përballë ishin ulur gra me minifunde dimri. Popull i bukur, i kulturuar, - thashë me vete...

Shinat e trenit më kujtuan shinat në minierat e tmerrshme në burgun e Spaçit... Dhe nguteshim të kapnim vagonin që shtyhej më lehtë nga të

tjerët, që ne, të burgosurit, e quanim “Gomulka” se ishte vagon polak. Policët s’kuptonin pse e quanim kështu, por komisari i burgut kërcëllinte mbi ne: armiq jeni ju, të pandreqshëm... Dhe buzëqesha kot. Në fakt m’u shfaq nëndrejtori i shkollës kur na shante se i kishim flokët e gjata si rinia revizioniste a pantallonat *kouboj*, qethu, “polak”, ç’i ke këto baseta... na bërtiste nëndrejtori ashtu siç u bërtitej të burgosurve. Polak? Po kjo është mrekulli, më vinte t’i përgjigjesha...

Marinar Maksi, miku im në burg, më tregonte në terr, nëntokë, për Poloninë, në Gdans, thoshte, kishte parë një basorelief të Skënderebut. Sa vend i bukur, sa njerëz të kulturuar!...

Erdhi treni ynë. Më kishte sjellë poezia në Poloni, poezia që në vendin tim më kishte futur në burg.

Do të shkonim larg. Mjegull në rrafshina, pyje të zhveshur dimërorë, por s’ishte ftohtë, dielli si në baladat tona na lëbyrte sytë. Treni ndali diku, ku zbritën mjaft udhëtarë, ku jemi? Katovica? Është e vërtetë apo trill... politik? Aty u mbloodhën sundimtarët e shteteve të perandorisë komuniste dhe pranuan kapitullimin e sistemit dhe vendosën strategjinë e fitoreve të tyre vetanake, ku të mundnin. Vërtet?...

U drodha befaz. Kisha parë filmin “Katyn” në Romë, tronditës, dilnim të trullosur nga salla e kinemasë të gjithë, sikur të kishim dalë nga një gropë, varr- masiv. Polonia martire dhe triumfuese...

Treni shkundulloi dhe unë hapa bllokun të shkruaja diçka, një mbresë, një poezi. Na thanë se dolëm në Çeki, peizazh i ngashëm, por mjegulla u pakësua. Po kërkoja të pikasja paksa nga Kafka dhe Shvejku, po e pamundur.

Në stacion, më dukej se quhej Bohumin, na priste ai që na kishte ftuar, avokati Jan Michal Stuchly poet dhe piktor. Me veturën e tij dolëm ne anën tjetër të lumit Odra, në bregun polak dhe, mbërritëm në qytetin Raciborz, u vendosëm në hotelin “Polonia”. Qytet i vogël, i pastër, me njerëz të përzemërt, me rrugë të gjera e ura e parqe, katedrale e statuja, pastaj permendorja e poetit german „Jozef Freiherr von Eichendorff” e periudhes se romantizmit dhe këdo që pyesje në anglisht për diçka, të përgjigjej menjëherë buzagas.

Avokati Jan Michal Stuchly na çoi dhe në shtëpinë tij të dytë në pyll, Ne Pogrzebien. Mureve pamë nga punët e tij, pejzazhe, kurse pas xhamave pejzazhet e mrekullueshme të Polonisë.

Një drekë e kaluam me kryetarin e bashkisë, z. Mirosław Lenk dhe drejtoreshën e muzeut të qytetit, znj. Joanna Muszala – Cialowicz. Çudi, përveç të tjerash, në muze kishte dhe një mumje egjipti, e kishte blerë për qytetin një i pasur, kont a aventurier, s’e di. Vizituam këshjellën e qytetit te Raciborit, „Keshtjella Piastowski” Në oborr pusi i fatit dhe i lumturisë, kështu quhej.

Në Seline e Shoqates te Dashamireve te Artit te Raciborzit, Jan Michal Stuchly, i veshur me frak të zi, me papion, shkëlqente urtësisht, teksa drejtonte mbrëmjen poetike, ku ne folëm për poezinë e tij dhe lexuam dhe nga poezitë tona.

Nuk ka shumë rëndësi në je i njohur ose jo me poezinë tënde në vendin tënd, por ka rëndësi që jeton me poezinë, që krijon gjendje poetike

mes njerëzve, klimë poezie. Vargjet më të bukura për mua ishin rreshti i poemës së atyre syve të grave e burrave që dëgjonin të mrekulluar.

Ah, Polonia është e bukur si poezia e saj! – kjo mbresë më ka mbetur ende, e pashlyeshme aq sa më vjen të pyes: e pashë vërtet Poloninë apo ish në ëndërr?

Visar Zhiti
Tiranë, prill 2014